| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 1** | **P01110.O1.A1**.<br>Mbështetje përfunksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe kryetarëte fshatrave) | **Funksioni 1:** Shërbime të Përgjithshme Publike<br>**N/Funksioni 011:** Organet ekzekutive dhe legjislative, përçështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme.<br>**Programi 01110:** Planifikim Menaxhim dheAdministrim. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Në zbatim te Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore Këshilli Bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Këshilli Bashkiak ka disa detyra dhe kompetenca:

a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
c) emëron dhe shkarkon sekretarin e Këshillit Bashkiak;
ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të Bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të Bashkisë;
e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të Bashkisë;
f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
i) zgjedh përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
k) miraton norma e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, .......
l) vendos për simbolet e Bashkisë;
ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë;
m) jep tituj nderi dhe stimuj;
n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te Bashkia.

Për mbështetjen e funksionimit të organeve të zgjedhura vendore ku përfshihen Këshilli i Bashkisë Shkodër me 51 anëtarë dhe 92 kryetare fshati të Njësive Administrative në territorin e Bashkisë Shkodër, zbatohet VKM nr. 177, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin. Nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve të njësive të vetëqeverisjes vendore", i cili rregullon efektet e masës së shpërblimit për anëtarët e Këshillit të Bashkisë Shkodër dhe kryetaret e fshatrave e Njësive Administrative. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit dhe kryetareve te fshatit të njësive administrative kryhet në formën e shperblimit (honorareve), në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Me mbështetjen financiare dhe logjistike të projektit Bashki të Forta si dhe mbështetjen financiare e teknike të Bashkisë Shkodër, në zbatim të funksioneve dhe detyrave, të zgjedhur për përfaqësim në nivel vendor në këshillin bashkiak, është përmirësimi i informacionit dhe mirëmbajtja e regjistrIt të projekteve dhe akteve ligjore në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër, si dhe implementimi platforma e ndërveprimit me qytetarët.
Si rezultat, të mbështetur mbi mjetet të teknologjisë së nformacionit dhe komunikimit, ndihmon në përmirësimin e kanaleve të komunikimit me qytetarët, rrit përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë mat performancën e punës dhe kryerjes së detyrave dhe funksioneve të Këshillit Bashkiak.

**ii. Synimi i projektit**

- Mbështetja e funksionimit të Këshilli i Bashkisë Shkodër dhe strukturave komunitare Njesive Administrative në territorin e Bashkisë Shkodër.
- Sigurimi i mbështetjes me shërbime operative për funksionimin e Këshillit Bashkiak, për aktivitetet e planifikuara sipas planit të miratuar me poshte.
- Garantimi i masës së shpërblimit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak për anëtarët e tij dhe kryetaret e fshatrave te Njësive Administrative.
- Përmirësimi i kanaleve të komunikimit me qytetarët, rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë matja punës dhe kryerjes së detyrave dhe funksioneve të Këshillit Bashkiak.

Për të gjitha aktivitetet e planifikuara do të zbatohet ligji "Për Menaxhimin fiannciar dhe kontrollin financiar", ligji "Për prokurimin publik që nga planifikimi, specifikimet teknike, rezultatet, prokurimi, kontrata, zbatimi, monitorimi dhe kontrolli.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

**KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR**
**PLANI i AKTIVITETEVE PËR VITIN 2022**

| Muaji | FUSHA VENDORE |
|---|---|
| **Janar** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Shqyrtim i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave |
| | Informim i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit Bashkiak, llogaridhënia e Këshillit Bashkiak; Prezantim i raportit vjetor të punës së Këshillit Bashkiak |
| | Vizitë studimore në NJQV jasht vendit |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Shkurt** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Pjesmarrje në trainime për Sekretarin e KB |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Mars** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Miratimi i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave |
| | Shqyrtim i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Prill** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Hartimi i palnit të monitorimit të shërbimit të pastrimit/Transportit/Ndriçimit/Shërbimeve Sociale-Arsimit bazë dhe parashkollor/Investimeve publike etj.<br>Kërkesë drejtuar Bashkisë për të raportuar në lidhje me këto shërbime- Monitorim dhe hartimi i Raportit nga Komisioni/ Raportimi ne Këshillin Bashkiak |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Maj** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Paraqitja e raportit per akivitetin financiar dhe zbatimin e buxhetit vjetor te vitit paraardhes i cili duhet të jetë i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor |
| | Analizë/Monitorim i punës së ndërrmarrjes Ujësjellës/Kanalizime sha |
| | Pjesmarrje në trainime për Sekretarin e KB |
| | Pjesmarrje në trainime për këshilltarët |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Qershor** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Miratim i PBA, duke shprehur edhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave |
| | Monitorimi i zbatimit te buxhetit për periudhën |
| | Rishikim buxheti |
| | Informim i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit, llogaridhënia e këshillit-Promovim i Procedurave të Ankesave, Kërkesave, Peticioneve dhe Nismave Qytetare |
| | Ceremoni për dhenie titull nderi |
| | Hartimi i palnit të monitorimit të shërbimit të pastrimit/Transportit/Ndriçimit/Shërbimeve Sociale-Arsimit bazë dhe parashkollor/Investimeve publike etj.<br>Kërkesë drejtuar Bashkisë për të raportuar në lidhje me këto shërbime- Monitorim dhe hartimi i Raportit nga Komisioni/ Raportimi ne Këshillin Bashkiak |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Korrik** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Miratimi i tavaneve perfundimtare te PBA |
| | Ndryshim buxheti |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Gusht** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Ndryshim buxheti |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Shtator** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |

| | |
|---|---|
| | Ndryshim buxheti |
| | Vizitë studimore jashtë vendit |
| | Hartimi i palnit të monitorimit të shërbimit të pastrimit/Transportit/Ndriçimit/Shërbimeve Sociale-Arsimit bazë dhe parashkollor/Investimeve publike etj.<br>Kërkesë drejtuar Bashkisë për të raportuar në lidhje me këto shërbime- Monitorim dhe hartimi i Raportit nga Komisioni/ Raportimi ne Këshillin Bashkiak |
| | Hartimi i raportit të dëgjesave |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Tetor** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Ndryshim buxheti |
| | Monitorimi i realizmit te 8-mujorit |
| | Konsultime me komunitetin për Shërbimin e pastrimit/Transportit/Ndriçimit/Shërbimeve Sociale-Arsimit bazë dhe parashkollor |
| | Hartimi i raportit të dëgjesave |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Nentor** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Konsultime me komunitetin për Shërbimin e pastrimit/Transportit/Ndriçimit/Shërbimeve Sociale-Arsimit bazë dhe parashkollor |
| | Hartimi i raportit të dëgjesave |
| | Kërkesë drejtuar Bashkisë në mbledhjen e këshillit për të reflektuar shqetësimet e qytetarëve në buxhet |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |
| **Dhjetor** | Mbledhje Keshillit Bashkiak |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme të KB |
| | Miratimi i buxhetit vjetor dhe PBA |
| | Miratimi i paketës fiskale |
| | Miratimi i prioriteteve të investimeve në bashki |
| | Emision ne median vendore dhe online për buxhetin |
| | Pjesmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca dhe aktivitete me interes për KB |

- Sigurimi i mbështetjes me shërbimeve operative për funksionimin e Këshillit Bashkiak, për aktivitetet e planifikuara sipas planit me poshte:[2]
  - Dërgim me postë i dokumeneteve, shkresave te keshillit dhe këshilltareve
  - Kancelari
  - Transport
  - Udhetim (Vizite jashte vendit)
  - Akomodim (vizite jashte vendit)
  - Shpenzime catering /coffee break
  - Shpenzime pritje percjellje
- Realizimi i shpërblimit mujor për anëtarët e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Shkodër dhe kryetareve te fshatit të Njësive Administrative sistematikisht dhe me korrektësi për çdo muaj.

**b) Rezultatet që prisni**

- Funksionimi sipas ligjit i Bashkise Shkoder si rezultat i miratimit ne kohe te te gjithe akteve te paraqitura ne mbledhjet e Këshillit Bashkiak.
- Miratimi i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave/ Ardhurave dhe shenzimeve
- Komuniteti i informuar si rezultat i transparences dhe llogaridhenies per veprimtarinë së Këshillit Bashkiak/
- Keshilli Bashkiak aktiv dhe pjesëmarrjes në aktivitete te rendesishme vendore, konferenca, dhe aktivitete me interes për KB
- Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve i miratuar.
- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel te shqyrtuara dhe te miratuara
- Shërbimit i Pastrimit / Transportit / Ndricimit / Shërbimeve sociale / Arsimit baze dhe parashkollor/ Investimeve publike te monitoruara dhe te permiresuara;
- Ndërmarrja Ujësjellës/Kanalizime te analizuar/monitoruar.
- Aftesite e Sekretariatin e KB dhe keshilltareve te rritura dhe te permiresuara.
- Komuniteti dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit te permiresuara-Procedurat e Ankesave, Kerkesave, Peticioneve dhe Nismave Qytetare te promovuara.
- Forumi e Shoqerise Civile dhe Rinise i informuar per punen e keshillit; Promovimi i Peticioneve dhe Iniciativave qytetarei kryer.
- Komuniteti i konsultuar per Sherbimet e pastrimit, per Sherbimin te Pastrimit, te transportit , Ndricimit, te Sherbimeve sociale, te Arsimit baze dhe parashkollor.

- Buxheti vjetor dhe PBA te miratuar/ Paketa fiskale e miratuar/ Prioriteve e investimeve ne bashki te miratuar.
- Komuniteti i Bashkise Shkoder i mireinformuar per buxhetin e Bashkise dhe aktivitetin e Keshillit Bashkiak ne media vendore dhe online.

Përmirësim i komunikimit me qytetarë, rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe matja e performances së kryerjes së detyrave dhe funksioneve të Këshillit Bashkiak.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Komisioni i financave, buxhetit, dhe aseteve publike<br>• Sekretari i Keshillit Bashkiak<br>• Të gjitha drejtoritë e Bashkisë<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br>• Drejtoria e Financës<br>• Njësitë Administrative (Administratorët)<br>• Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër | Bashkia e Shkodrës |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | Totali ( mijëlekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Shpërblim<br>Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit ( 51 anëtarë) | **9,988** | | | 9,988 | | |
| A.2 | Shpërblim<br>Kryetar fshati (92 kryepleq) | **7,612** | | | 7,612 | | |
| A.3 | Mirëmbajtje e platformës së integruar përkomunikimin me qytetarët | **0** | | | 0 | | |
| A.4 | Vizitë studimore në NJQV jasht vendit | **3,630** | | | **3,630** | | |
| | **Shuma** | **21,230** | | | **21,230** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2023** | | Totali ( mijëlekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Shpërblim<br>Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit ( 51 anëtarë) | **10,188** | | | 10,188 | | |
| A.2 | Shpërblim<br>Kryetar fshati (92 kryepleq) | **7,764** | | | 7,764 | | |
| A.3 | Mirëmbajtje e platformës së integruar për komunikimin me qytetarët | **0** | | | 0 | | |
| | **Shuma** | **17,952** | | | **17,952** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali ( mijëlekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Shpërblim<br>Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit ( 51 anëtarë) | **10,391** | | | 10,391 | | |
| A.2 | Shpërblim<br>Kryetar fshati (92 kryepleq) | **7,920** | | | 7,920 | | |
| A.3 | Mirëmbajtje e platformës së integruar për komunikimin me qytetarët | **0** | | | 0 | | |
| | **Shuma** | **18,311** | | | **18,311** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar 2022– Dhjetor 2024 | Drejtoria e Financës<br>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |